

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi, Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajci, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarës M.SH. nga për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.3 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarës M.SH, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.121/17 datë 23.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 27.09.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarës M.SH., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.121/17 datë 23.07.2018, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktgjykimin PKR.nr.121/17 datë 23.07.2018, e ka shpallur fajtorë të akuzuarën M.SH. për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1 pika 1.3 të KPRK-së dhe për këtë vepër penale e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 12 viteve në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 10.05.2017 deri më datën 11.06.2018. Të akuzuarës i është vazhduar masa e paraburgimit nga data 10.05.2017 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo më tepër se 12 vite. Lidhur me kërkesën pasurore juridike të dëmtuarit janë udhëzuar në procedurë civile kontestimore për realizimin e kërkesës pasurore juridike. E akuzuara është detyruar që ti paguajë shpenzimet procedurale dhe të ekspertit psikiatrik, shumën prej 582.54 euro, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 160 euro ku shuma prej 60 euro sipas ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto e akuzuara është e obliguar që ti paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.. Për shpenzimet e tjera gjykata do të vendosë pas sigurimit të listës definitive të shpenzimeve me aktvendim të veçantë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarës av. K.O., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënim me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta anulon dhe lëndën ta kthen në rigjykim dhe rivendosje apo ta ndryshojë përkitazi me sanksionin penal apo kualifikimin juridik ta ndryshoj dhe të akuzuarës të i shqiptoj dënim më të ulët konform kualifikimit të ri

Gjykata e Apelit caktoi seancën e kolegjit në të cilën mori pjesë Prokurori i Apelit Haxhi Dërguti, e akuzuara M.SH., av. G.R. të cilin kjo gjykatë me pëlqimin e të akuzuarës ia ka caktuar sipas detyrës zyrtare pasi që mbrojtësi i saj po ashtu i caktuar sipas detyrës zyrtare av. K.O. edhe pse i ftuar me rregull nuk mori pjesë në seancë. Prokurori i Apelit mbeti pranë parashtrësës me shkrim PPA/I.nr.377/18 të dt.10.09. 2018 , me të cilën ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarës dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimorët nga ana e mbrojtës për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që dispozitivi është i paqartë dhe në kundërshtim me arsyetimin, nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike ndërsa faktet dhe konkludimet nuk kanë mbështetje në provat e administruara. Me paragrafin 1.8 të nenit 384 të KPP aktgjykimi nuki mund të bazohet në prova të pa pranueshme dhe të pa mbështetshme ndërsa trupi gjykues aktgjykimin e ka bazuar në dëshminë e dëshmitarëve B.M. dhe V.S., të cilat prova janë të pa mbështetshme dhe të pa pranueshme dhe në kundërshtim me nenin 259 par.2 lidhur me nenin 19 par.1 nën.par 1.29 të KPP, pasi që asnjëri prej tyre nuk ka qenë prezent në momentin kur ka ndodhur vrasja si dhe faktin se sipas këtyre dëshmitarëve e akuzuara dhe i ndjeri kanë qëndruar së bashku me dëshmitarët, kanë pir alkohol dhe prej orës 15, i ndjeri dhe e akuzuara kanë ardh gjysmë ore pas kësaj duke qëndruar deri në ora 17,30 kur kanë shkuar kurse e akuzuara është kthyer pas dy orëve dhe se gjatë kësaj kohe i ndjeri dhe e akuzuara kanë pasur vetëm grindje por assesi nuk është përdorur dhuna fizike. Nuk është sqaruar rrethana e rastit, nuk ka ekzistuar motivi për vrasje dhe nuk është dëshmuar asnjë rrethanë që tregon mundësinë e ndërmarrjes së veprimit të vrasjes nga se kishin pir shumë alkohol, e akuzuara ka konstrukt trupor shumë të dobët ndërsa i ndjeri ishte shumë më i fuqishëm, të dy kanë shkuar së bashku dhe po të kishte problem mes tyre do të përdorej dhuna në prezencë të tyre dhe nuk do të shkonin së bashku në dhomë. Thekson se duhet të aplikohet parimi in dubio pro reo në rastin konkret. Se nuk janë bërë ekzaminimi i gjurmëve në rrip me të cilën pretendohet se është kryer vepra penale apo në lokacionin ku ka ndodh vrasja. Konsideron se si pasojë e këtyre shkeljeve të cekura më lartë është shkelur edhe Ligji Penal në dëm të akuzuarës pasi është shpallur fajtor për një vepër të cilën nuk e ka kryer. Po ashtu vlerëson se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht pasi me asnjë provë nuk është vërtetuar se e akuzuara ka kryer veprën penale në fjalë. Nuk kontestohet fakti i grindjes por nuk dëshmohet kryerja e veprimit të vrasjes nga ana e të akuzuarës.

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara nga mbrojtja por edhe ato për te cilat kjo gjykatë është e obliguar sipas detyrës zyrtare ti shqyrtojë. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet për faktet vendimtare duke arsyetuar secilën provë veç e veç dhe duke i ndërlidhur me njëra tjetrën, duke vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse,

arsyet e mosmiratimit të propozimeve konkrete të palëve duke dhënë arsye të mjaftueshme në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje juridike e posaçërisht me rastin e vërtetimit të veprës penale ashtu sic e ka kualifikuar gjykata e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë ka administruar si prova materiale raportin e autopsisë të dt 11.05.2017, vërtetimin mbi rezultatin e alkoolit, të dt. 10.05.2017, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i dt. 10.05.2017, foto dokumentacioni nga shkresat e lëndës, raporti i ekspertizës psikiatrike nr. 87/2, 7 faqe i dt. 22.05.2018 nga Instituti i psikiatriisë Forenzike të Kosovës si dhe ka dëgjuar dëshmitarët B.M., V.S., G.Z., N.P., ka lexuar deklaratën e dëshmitarit M.GJ. të dhënë në polici si dhe është dëgjuar në cilësi të ekspertit mjeko-ligjor të psikiatris Dr. F.D. dhe nga këto prova gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar faktet jo kontestuese siq janë > se i ndjeri dhe e akuzuara ishin në lidhje dashurie, kishin bashkëjetuar, se me datë 10.05.2017 rreth orës 18,15 në Mitrovicë të Veriut në pas një zënke në mes të ndjerit dhe të akuzuarës e njëjta me rrip e shtrëngon viktimën në fyt me q rast i ndjeri vdes e që vërtetohet nga palët por edhe provat e administruara në shqyrtim gjyqësor gjegjësisht në raportin e autopsisë ku vërtetohet se deri te vdekja ka ardhë si pasojë e mbylljes së frymëmarrjes dhe mungesës së oksigjenit në organet vitale jetësore, pastaj nga dëshmitari B.M. dhe V.S. ku ka theksuar se pas fjalosjes ndërmjet viktimës dhe të pandehurës ata kanë shkuar në dhomën nr. 40 dhe e akuzuara është kthyer në dhomë ku ishin këta dy dëshmitar dhe e akuzuara iu ka thënë se e ka ngulfatur të ndjerin e ku dëshmitari B. ka shkuar në dhomë të të ndjerit dhe e kishte gjetur të shtrirë në dysheme pa shenja jete e që kjo është në përputhje edhe me raportin e autopsisë., fotodokumentacionit dhe raportit të vendit të ngjarjes e ku shihet edhe rripi që ka mbetur i varrur në karrikë pas ngulfatjes që e akuzuara ja kishte bërë të ndjerit. Nuk ka qenë kontestuese edhe gjendja e dehur e të akuzuarës ku përqindja në gjak ishte 329% që vërtetohet edhe nga palët por edhe nga alkohol testi i kryer nga policia. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar pretendimet e mbrojtjes se e akuzuara nuk ka pasur paramendim për kryerjen e veprës penale të Vrasjes së rëndë duke pretenduar se kemi të bëjmë me vepër tjetër penale pasi formën e cilësuar të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nën.par 1.3 e bën fakti i raportit të viktimës me të akuzuarën e që ka mbështetje edhe në nenin 120 par 32 e që bashkëshortin jashtëmartesor e konsideron anëtarë të familjes ndërsa nga provat që janë vërtetua është vërtetua se të njëjtit kanë pas bashkësi jashtë martesore. Me të drejtë gjykata dëshmitarëve B. dhe V. ua ka falur besimin pasi që të njëjtit edhe pse nuk ishin dëshmitar okular dëshmitë e tre ishin në përputhje të plotë me provat materiale dhe atë raportin e autopsisë, fotodokumentacionin dhe raportin e vendshiqimit nga vendi i ngjarjes e po ashtu edhe dëshmisë së dëshmitarëve G.Z. dhe N.P. me të drejtë ua ka falur besimin pavarësisht se ata nuk ishin dëshmitar okular por kanë vërtetuar fakte të rëndësishme siq është bashkëjetesa e viktimës dhe të akuzuarës, raportet ndërmjet tyre, personalitetin e tyre por që bazuar edhe në provat e tjera të cekura më lartë pa mëdysheje vërtetojnë veprimet e të akuzuarës në drejtim të veprës penale për të cilën ajo është akuzuar dhe shpallur fajtoare.

Meqë në aktgjykimin e atakuar nuk kemi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të ligjit penal.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtjes nuk janë të bazuara. Në ankesë nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit, por mbrojtja thekson se bazuar në atë se aktgjykimi është marrë me shkelje të cekura më lartë edhe vendimi mbi dënim është i kundërligjshëm mirëpo edhe po të konstatohej se është vërtetuar gjendja faktike dënimi është i rëndë edhe pse është konstatuar nga ekspertët çrregullimi kufitar i personalitetit apo aftësia e zvogëluar. Mirëpo kjo Gjykatë vlerëson se duke pas parasysh rrethanat rënduese të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë siq janë shkalla e përgjegjësisë penale, intensitetin e vlerës së mbrojtur ku është humbur jeta e një njeriu si dhe motivin e kryerjes së kësaj vepre penale dhe rrethanat lehtësuese si gjendja e aftësisë së zvogëluar por jo esenciale, se fillimisht me të ndjerin ka patur mosmarrëveshje dhe të dy kishin konsumuar alkohol dhe ka qenë nën ndikim të alkoholit, se është nënë e një fëmije për të cilën kujdeset nëna e të akuzuarës, nuk është e punësuar, nuk kishte një stabilitet psikik, është e moshës së mesme, raportet e të pandehurës me të ndjerin , sjelljen e sajë pas kryerjes së veprës penale, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarës nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarës si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.399/2018, më 27.09.2018

Procesmbajtësja,
Leonita Lajci_____

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj _____

Anëtarët e kolegjit:

2.Dr.sc. Driton Muharremi_____

3. Abdullah Ahmeti_____